



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 27.3.2023

Nr: 210

Ora: 14:00

V E N D I M

P Ë R

**PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT PËR TRAJNERËT E OPERATORËVE TEKNIKË PËR PËRDORIMIN E PAJISJES SË IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE (PEI), PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 14, pika 2, nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I N:

1. Trajnerët e operatorëve teknikë për përdorimin e pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve (PEI), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore datë 14 maj 2023, përfitojnë shpërblim në masën 750 (shtatëqind e pesëdhjetë) lekë/orë trajnimi dhe në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për funksionin dhe detyrat si suport terreni.
2. Efekti financiar sipas pikës 1 të këtij vendimi, përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2023, për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Lealba PELINKU

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 27.3.2023 Nr: 210  
Ora: 14:00



“Për përcaktimin e masës së shpërblimit për trajnerët e operatorëve teknikë për përdorimin e pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve (PEI), në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”